



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

P.nr.710/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Selvije Kostërci, në lëndën penale ndaj të pandehurit A.Sh nga ..., për shkak te veprës penale: Grabitje nga neni 255 par.1 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Përkohshëm së Kosovës (tutje: KPPK), duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.nr. 104/2011, datë 22.11.2011, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt. 26.06.2019 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Natasa Radovic dhe të pandehurit, me datë 28.06.2019 shpalli publikisht, ndërsa me datë 17.07.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.Sh, me nofkën "...", nga i ati Rr., e ëma H., e vajzërisë J., i lindur me datë ... në fshatin ..., komuna e ..., ku edhe jeton, i pa punë, i pa martuar, ka të përfunduar shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, edhe më parë i dënuar.

ËSHTË FAJTORË

Sepse,

Me datë 13.08.2011, rreth orës 17:30 minuta, në rr."..." afër parkut "..." në ..., në bashkëkryerje e me qëllim që të marrin pasurin e luajtshme të tjetrit dhe veti t'i sjellin dobi pasurore të kundërligjshme, duke përdorë forcën, pasi që më herët kanë vërejtur në fytin e të dëmtuares N.J një zingjirë të arit, e kanë përcjellur nja 20-30 metra, kur i pandehuri J. ka ecur mbrapa të dëmtuares duke bërë roje ndërsa i pandehuri A. është afruar afër të dëmtuares, duke përdorur forcën i ka hjek zingjirin e arit të dëmtuares nga fyti dhe që të dy të pandehurit kanë filluar të ikin nga vendi i ngjarjes, edhe pse, në ato momente, aty ka kaluar polici B.I me veturën e tij private, i cili ka parë rastin dhe ka arrit të ndal të pandehurin A.Sh ndërsa i pandehuri tjetër ka ikur nga vendi i ngjarjes.

Me këtë ka kryer veprën penale: Grabitje neni 255 par. 1 e lidhur me nenin 23 të KPPK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 1, 3, 6, 11, 15, 23, 31, 34, 35, 36, 38, 64, e 73 të KPPK-së, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, e:

G J Y K O N

1. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e pesë (5) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

2. Të pandehurit në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 13.08.2011 e deri me datë 12.09.2011.
3. Obligohet i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
4. Pala e dëmtuar, N.J, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.nr.104/2011 të datës 22.11.2011, kundër të pandehurit A.Sh nga ... për shkak te veprës penale: Grabitje nga neni 255 par.1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ashtu që në këtë seancë i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, duke theksuar se e ndjej veten fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, ka shprehur keqardhje për atë që ka ndodhur.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale nga të cilat edhe është ngritur aktakuza, se ky pranim bëhet në mënyrë vullnetare, pa presion andaj, i ka propozuar gjykatës që ta pranoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe me rastin e shqiptimit të dënimit të merr parasysht të gjitha rrethanat.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Raporti policor me nr. të referencës ..., të datës 13.08.2011; Deklarata e të pandehurit A.Sh dhënë në polici e datës 13.08.2011; Deklarata e të dëmtuarës N.J e datës 13.08.2011; Vërtetim mbi marrjen e sendeve i datës 13.08.2011; Vërtetim mbi kthimin e sendeve i datës 13.08.2011; Fotoalbumi. Të gjitha këto prova janë bindese për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit te fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej çdo dyshimi se i pandehuri, me veprimet e tij, ka kryer veprën penale: Grabitje nga neni 255 par.1 të KPRK-së, e për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 64 të KPPK-ës. Si rrethana rënduese ka gjetur shkallen e përgjegjesisë penale gjë që nga provat rezulton se i pandehuri këtë veprë e kishte kryer me dashje, mënyrën e veprimit të kryerjes së veprës pasi që me veprimet e tij e ka rrezikuar shëndetin e të dëmtuarës, ashtuqë duke e përdorur forcën ia kishte shkëput nga fyti zingjirin të dëmtuarës, si dhe faktin se edhe më parë ka qenë i dënuar për veprë penale.

Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shprehur keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, faktin se nga koha e kryerjes së veprës penale, që është vitit 2011 e deri më tani ka kaluar një kohë relativisht e gjatë, rreth 8 vite, si dhe faktin se menjëherë ishte kompensuar dëmi pasi që zingjiri i ishte kthyer të dëmtuarës.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitivë të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij dënimi, i paraparë sipas nenit 34 të KPPK-ës, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandaloje kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, dhe nga të gjitha këto ka konsideruar se dënim i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallen e përgjegjesisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale për te pandehurin.

Vendimi për llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar është bazuar në nenin 73 të KPPK-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 463 të KPP-së.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 të KPPK-ës nga arsyeje të lartcekura ka vendosur si në dispozitivë të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.710/2019 dt.17.07.2019

Procesmbajtësja:
Selvije Kostërci

Gjyqtari

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.